



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:048136

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05497276

A.nr.571/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni, dhe me sekretaren juridike Sanie Salihu, në konfliktin administrativ sipas padisë të paditëses, F.P. nga, të cilën e përfaqëson, kundër të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transferave Prishtinë, Departamenti i Pensioneve, për shkak të anulimit të aktvendimit, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur në prani të paditëses dhe përfaqësuesit të saj dhe në mungesë të palës së paditurës, me datë 25.03.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, dhe anulohet vendimi me numër të dosjes 6002010 i datës ..., i të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transferave Prishtinë, Departamenti i Pensioneve, dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

II. Obligohet e paditura, të veprojë nga pikëpamja juridike e kësaj gjykate si dhe nga vërejtjet e dhëna lidhur me procedurën.

A r s y e t i m

Gjykata ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ gjyqësor në pajtim dispozitat e nenit 41 të LKA-së, në prani të palës paditëse dhe përfaqësuesit të paditëses dhe mungesë palës së paditurës, e ftuar në mënyrë të rregullt gjyqësore.

Paditësja në padinë e date 15.03.2021, ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia saj si e bazuar dhe të anulohet vendimi kontestues i të paditurës i datës 05.02.2021 , si i pabazuar në ligj, dhe ashtu ti njihet e drejta e pensionit me pa aftësi të përhershme të kufizuar dhe kjo nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Ndërsa përfaqësuesi i paditëses në seancën e shqyrtimit kryesore ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia e paditëses si e bazuar, ashtu që të anulohet vendimi kontestues i të paditurës i datës 05.02.2021 me nr. dosjes 6002010 si i pabazuar në ligj. E njoftoi gjykatën që po ashtu për çështje të njëjta është aprovuar si ankesa ashtu edhe padia në gjykatë, andaj edhe unë konsideroi që është person me aftësi të kufizuar dhe ti njihet kjo e drejtë nga e paditura. Kërkoj nga gjykata që edhe njëherë çështja saj të shkoj në komision mjekësor tek e paditura në mënyrë që të vlerësojnë gjendjen saj shëndetësore, para ashtu që çështja të shkoi në rivendosi tek e paditura.

E paditura në përgjigjen në padi/ parashtresën të parashtruar me datë 08.03.2024, e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar duke theksuar se, Komisioni i Ankesave pajtohet me vlerësimin e komisionit mjekësor të shkallës së parë që nuk i plotëson kriteret për Pensionin e personave me aftësi të Kufizuar dhe si e tillë refuzohet ankesa si e pa bazuar siç përcaktohet sipas dispozitave ligjore të Ligjit, nr.2003/23. Pas administrimit të provave, i propozon gjykatës që të refuzojë kërkesë padinë e paditësit në tërësi si të pa bazuar, dhe të mbetet në fuqi vendimi i të paditurës.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 25.03.2024 ka administruar provat relevante dhe atë: vendimi i dt.05.02.21 me nr. dosjes 6002010, vërtetimi nga QKUK i dt.03.09.21, udhëzimi i dt.08.03.21, deklarata e bashkësisë familjare dt.03.03.21, vendimi dt.12.11.20, vërtetimi i dt.03.03.21, vërtetimi i papunësisë dt.13.07.20, raporti mjekësor dt.08.02.20, udhëzimi i dt.19.02.20, udhëzimi për konsultim dt.21.10.18, raporti mjekësor dt.09.09.20, ankesa dt.08.01.21, vendimi dt.12.12.20, vërtetimi i dt.07.04.20, i lëshuar nga Shoqata e të Shurdhërve, udhëzimi për konsultim dt. 20.09.18, raportoi nga konsulta dt.21.10.18, vlerësim i komisioni mjekësor-konstatim i dt.10.11.20, shqyrtimi i ankesave dt.28.02.20, vendimi i dt.28.12.11, vendimi dt.06.10.11, vlerësimi i komisionit mjekësor 28.09.11, shqyrtimi i ankesave dt.17.01.11.

Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 44 të Ligjit për Konfliktet administrative, vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë çështje administrative dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.

Për të vlerësuar këtë, gjykata fillimisht i'u referua nenit 9, paragrafët 1 dhe 5, të Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, i cili përcakton se: "Pensioni i paaftësisë të përhershme do t'i ofrojë mbështetje financiare personave të përzgjedhur në përputhje me kriteret e përcaktuara me këtë ligj, sipas mjeteve të ndara për këtë qëllim nga Buxheti i Republikës së Kosovës"; "5. Një person do të konsiderohet me pa aftësi të përhershme, nëse: 5.1. ofron dëshmi se është me pa aftësi të përhershme para se të aplikojë për pension, duke siguruar të gjitha dëshmitë mjekësore; 5.2. Komisioni Mjekësor vlerëson

se ekziston pa aftësia e përhershme e punës të parashtruesi i kërkesës; 5.3. Komisioni Mjekësor vlerëson paaftësinë në kohëzgjatje për periudhën prej një (1), tre (3) apo katër (4) vitesh;. 5.4. Pas skadimit të afateve të përcaktuara në nenin paragrafin 5.3 të këtij paragrafi personi i nënshtrohet procedurës së rivlerësimit mjekësor”.

Sipas dispozitave të nenit 48, të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, paragrafi 1 përcakton se, “Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyeën pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim”, ndërsa paragrafi 2 thekson, se: “2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërtshënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij, ndërsa në arsyetimin e të paditurës, shihet qartë se nuk janë respektuar këto dispozita.

Gjykata konstatoi se, MPMS-DP, ka nxjerrë vendim me numër dosje 6002010 të dates 05.02.2021, duke vepruar sipas ankesës ndaj vendimit, me të njëjtin numër të dosjes, të datës 12.11.2020, me të cilin refuzohet kërkesa, respektivisht ankesa e ankuesit. Vendimi ka të meta në arsyetim, siç është paraparë me dispozitat e nenit 48, paragrafit 1, nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5, dhe paragrafit 2 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA); ka zbatuar gabimisht dispozitën e ligjit material, respektivisht nenin 9, paragrafin 5, të Ligjit nr. 04/L-131, dispozitë kjo, mbi të cilin është bazuar arsyetimi i vendimit.

Gjykata si rregull konfliktin administrative e vendos në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga vendimi i goditur me padi nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike.

Në këtë mënyrë, vendimi konsiderohet se përmban të meta për shkak të të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave ligjore, të cilat pamundësojnë shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit ose edhe vendosjen në mënyrë meritore nga ana e gjykatës, andaj, gjykata konform nenit 43.2 të LKA-së, vendosi që çështjen ta kthejë në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura si dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në këtë drejtim, gjykata e obligon organin e paditur, në kuptim të nenit 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në ri-procedurë të veprorë sipas vërejtjeve të dhëna

në këtë aktgjykim, dhe pasi t'i mënjanojë të metat e cekura, të merr aktvendim të drejtë, të bazuar, udhëzues për palën paditëse në mbrojtje juridike dhe palët të njoftohen me kohë.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE

A.nr.571/2021- data: 25.03.2024

G j y q t a r e
Luljeta Maxhuni

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.